



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja Nr. 51

Prishtinë, 13.07.2016, duke filluar nga ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, kryetare; Müfera Shinik, nënkryetare e dytë dhe anëtarët e komisionit: Sasha Millosavljević, Sllavko Simić, Millka Vuletić, Agim Kikaj, Qerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi.

Munguan: Agim Çeku, Fisnik Ismaili dhe Rustem Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje : kryetari i KPMSHCK-së Shkëmb Maja dhe përfaqësueset Gjylinaze Gola dhe Lola Petković, përfaqësuese e OSBE-së Sanije Berisha, përfaqësues i KDI-së Vjollca Uka,, konsulltanti i Sekretariatit të KKK- Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz -Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivković**, kryesuese e Komisionit.
Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportimi i Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me implementimin nenit 11, të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.**

I ftuar: Kryetari i Këshillit z. Shkëmb Manaj

Kryetarja, hapi seancën dhe përshëndeti pjesëmarrësit, Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të cilët ishin të pranishëm në cilësi të raportuesit të zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil. Ajo vuri në dukje se ligji rregullon një çështjen të rëndësishme, siç është punësimi i komuniteteve pakicë në administratën publike.

Në të njëjtën kohë informoi pjesëmarrësit për aktivitetet e planifikuara dhe të ndërmarra nga Komisioni dhe GP për mbikëqyrje dhe për marrjen e informatave të e nevojshme zyrtare dhe të dhënat për nivelin zbatimit të tij, sidomos nenit 11, lidhur me përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë në shërbimin civil, organet publike në nivel qendror dhe lokal, Ajo theksoi se deri më tani nuk po respektohet dhe zbatohet neni 11 i ligjit nga institucionet lokale e qendrore, i cili nen rregullon kotat minimale dhe maksimale në bazë të përqindjes së 10% të vendeve të rezervuara që u përkasin komuniteteve. Të dhënat nuk pasqyrojnë situatën aktuale në terren dhe nuk shprehin parimin ligjor nga autoritetet, nga se është e rëndësishme që ky hetim parlamentar duhet të jet i besueshëm sepse parqet problem ligjor që imponon ndërhyrjen dhe gjetjen e zgjidhjes të drejtë dhe të barabartë për të gjitha komunitetet, pa favorizim.

Veton Berisha, me Planin e Punës për vitin 2015, në bazë të vendimit të komisionit është formuar GP për të mbikëqyrur e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, me ç'rast është identifikuar neni 11 i Ligjit si objekt i mbikëqyrjes së zbatimit për të përcaktuar nivelin e zbatimit të këtij neni në praktikë nga aspekti i komuniteteve jo-shumicë. Ai theksoi se sipas statistikave nuk ka realizim të punësimit të komuniteteve tjera, siç janë komuniteti serbe, turke dhe boshnjake, të cilët janë në një pozitë më të mirë. Pragu prej 10% ka të bëjë me administratën publike në tërësi dhe jo për secilin institucion veç e veç. Në shumë institucione, përfaqësimi i komunitetit egjiptian është më i ulët në proporcion me popullsinë dhe nuk mund të thuhet se „është e drejtë dhe proporcionale“. Ky trend i përfaqësimit të pamjaftueshëm është shqetësues nga se nuk po zgjidhen çështjet për rastet e punësimit. Prandaj, qëllimi i këtij takimi është kontributi në kuptim të marrjes së rekomandimeve të cilat do ti japim së bashku me raport.

Danush Ademi, Neni 11 i Ligjit për Shërbimin Civil rregullon dispozitat ligjore në lidhje me punësimin e pakicave në shërbimet e administratës publike. Sipas të dhënave zyrtare të siguruara nga MAP përfaqësimi i komuniteteve jo shqiptare në shërbimet qendrore dhe lokale të administratës publike shihet se anëtarët e komunitetit Ashkali, Egjiptas, Rom dhe Goranjanë të nën përfaqësuar. Shumë pak institucione kanë të dhëna për komunitetin të cilit i përkasin kandidatët dhe ka një problem identitet apo prezantimi të rrejshëm. Të gjitha institucionet duhet mbledhur të dhëna për aplikimet për punë në lidhje me komunitetet etnike dhe të punësuarve për qëllime të monitorimit dhe raportimit, sepse mbledhja e të dhënave deri tashti nuk ishte e mundur. Në shumë komuna anëtarët e komunitetit tim, nuk janë të punësuar në asnjë vendpune të administratës publike dhe madje edhe në ato komuna ku këto komunitete janë të pranishëm në numër relativisht të madh, Të punësuar janë kryesisht përfaqësues nga radhët e komunitetit shumicë. Si ta zgjidhim këtë çështje dhe gjejmë mënyrën për të rregulluar problematikëpërmes mekanizmave ligjor.

Qerim Bajrami, Ligji i Shërbimit Civil thotë se komuniteti dhe anëtarët e saj kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimet e autoriteteve dhe organeve të administratës publike qendrore dhe lokale. Anëtarët e komunitetit janë ende të nën përfaqësuar në administratën publike në nivel qendror dhe lokal. Ajo që ne kemi gjetur gjatë takimeve dhe dëgjimeve publike nga aspekti i zbatimit të nenit 11 të Ligjit, i cili përcakton 10% të vendeve të punës për komunitetet, por nuk specifikon se këto 10% janë të përfaqësuar nga përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve, prandaj shtrohet pyetja pse kjo kuotë nuk është më e madhe? Këtë problem ligjor duhet përmirësuar. Sidomos problem i madh është fenomeni i të punësuarve të rremë në aspektin e përfaqësimit të identitetit, sidomos në MFS të Kosovës. Grupi i punës që monitoron zbatimin e legjislacionit i kishte drejtuar pyetësorin përkatës MFS ku kërkohej statistika mbi përkatësinë

etnike të të punësuarve, siç kërkohet me nenin 8.9 dhe 10 të Rregullores. Kjo nuk është informacion të fshehtë dhe mund tamarrim, prandaj nuk do të heqim dorë. Ne duhet të këmbëngulin në krijimin e një sistemi elektronik të bazës së të dhënave, ku mund të shihet se kush është kush. Gjithashtu, MAP nuk ka mundur të sigurojë të dhënat e kërkuara në pozicionet më të larta funksionale, që do të thotë se vlerësimi i gjendjes së numrit të anëtarëve të komunitetit nuk ka qenë e mundur. Grupi ndërmintor ka formuar një GP për t'u marrë me këtë problem për të gjetur zgjidhjen më të mirë. Në të njëjtën kohë, duhet të gjejmë mekanizma dhe mënyra për të adresuar këtë çështje me qeverinë për të gjetur fonde buxhetore shtesë.

Agim Kikaj, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e kryen punën e tij në përputhje të plotë me mandatin kushtetues dhe ligjor për të mbikëqyrur zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në administratën publike në nivel qendror dhe lokal. Do të ishte shumë e dobishme që Këshilli të përpikët të sugjerojë dhe ndihmojë në gjetjen e mekanizmave për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Fjala hyrëse e kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, z. ShkëmbManaj.:

Komisioni është organ i pavarur që mbikëqyrë pajtueshmërinë e të gjitha rregullave dhe parimeve me kushtetutën dhe ligjet që rregullojnë Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe për punën e tij i raporton drejtpërdrejt Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës paraparë me nenin 101, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit Nr 03 /L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të republikës së Kosovës, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më qershor 2010. Dispozitat e Ligjit nr 03 /L-192 për Këshillin i Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, parashohin disa funksione të këshillit:

- shqyrton dhe merr vendime për ankesat nga nëpunësit civil kundër vendimeve të punësimit në të gjitha institucionet e shërbimit civil, në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
- vendos nëse emërimet e nëpunësve udhëheqës civilë janë bërë në përputhje me rregullat dhe parimet e përcaktuara në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
- Mbikëqyrë zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil;

Gjithashtu, në mënyrë që të kryejë funksionet e tij, Këshill mund të vizitojë çdo vend puneku janë të punësuar nëpunës civilë, të ketë qasjen dhe kontrollin e informacioneve të shkruara për rekrutimin, emërimin, procedurat disiplinore dhe avancimin e nëpunësve civilë ose lidhur me ankesat kundër vendimeve dhe lidhur me ankesat;

Gjatë vitit 2015, Këshilli ka marrë 613 ankesa nga nëpunësit civilë dhe kandidatët për punësim në Shërbimin Civil. Përveç këtyre 613 ankesave Këshilli ka shqyrtuar edhe 77 ankesa shtesë që janë bartura nga vitit 2014 për zgjidhje në 2015. Në bazë të këtyre të dhënave, del se në vitin 2015 Këshilli ka shqyrtuar gjithsej 690 ankesa. Në mënyrë meritore ka zgjidhur 632 ankesa dhe 58 ankesa janë bartur për të zgjidhur në afatin e paraparë ligjor në vitin 2016.

Në bazë të të dhënave të mbledhura në zbatimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore, gjegjësisht shqyrtimitt ë ankesave, procesit të mbikëqyrjes së emërimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues dhe rregullave të kontrollit të procesit dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil në administratën publike në nivel qendror dhe lokal ne kemi nxjerrë një vlerësim të përgjithshëm të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil në fushat përkatëse dhe kemi dhënë rekomandime për institucionet kompetente për të eliminuar shkeljet e regjistruara. Të dhënat statistikore tregojnë se përqindja e të punësuarve nga komunitetet pakicë në nivelin qendror janë 6.24% dhe atë lokal 16.83% çka mund të thuhet se e ka rritur numrin e të punësuarve nga radhët e komunitetit serb, ndërsa ky nuk është rasti me komunitetet tjera.

Në drejtim të zbatimit të funksioneve kushtetuese dhe ligjore për monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil nga institucionet e administratës publike qendrore dhe lokale në Republikën e Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, në vitin 2015 ka dhënë disa rekomandime të cilat i konsideron të nevojshme për funksionimin e administratës publike në përputhje me ligjin dhe standardet e njohura të administratës publike. Rekomandimet janë drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë, Ministrisë së Administratës Publike, Ministrisë së Financave, si dhe krerëve kryesorë të institucioneve të administratës publike në nivel qendror dhe lokal.

Në raportet e vitit 2015 për kontrollin e zbatimit e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për 41 institucione të nivelit qendror dhe lokal, Këshilli ka konstatuar dhe evidentuar 226 shkelje të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, dhe janë regjistruar 179 shkelje për çka ka dhënë rekomandime zyrtarëve gjegjës monitorues të atyre institucioneve.

Në vitin 2015, për shkak të mungesës së kapaciteteve financiare Këshilli nuk ishte në gjendje të realizojë vizitat monitoruese, siç e kemi në plan që edhe në vitin 2016 të realizojmë 77 vizita monitoruese.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

**Kryetare e Komisionit
Jasmina Živković**
